



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:040300

Datë: 06.11.2023

Numri i dokumentit: 04878000

PPP.nr.438/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtorin profesionale Fatmire Haziri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores S.G , nga fshati M. , Komuna e Prishtinës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arif Hasi, avokat nga Glllogoci, kundër debitores Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbarimit P.nr.197/20, të datës 02.03.2020, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Hakif L Hasi në Glllogoc, jashtë seancës gjyqësore, me datë 06.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht i bazuar prapësimi i debitores Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK, me seli në Prishtinë, dhe urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.197/20, i datës 02.03.2020 i Përmbaruesit Privat Hakif Hasi në Glllogoc, në shumën prej 78.00 €, SHFUQIZOHET.

II. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitores Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.197/20 të datës 02.03.2020 i Përmbaruesit Privat Hakif Hasi në Glllogoc, për shumën 756.96 €.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Hakif L. Hasi, në Glllogoc, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të parashtruar nga e autorizuari i kreditores S.G , nga Prishtina, ka lejuar përmbarimin në bazë të Urdhërit Përmbarimor P.nr.197/20, i datës 02.03.2020, në bazë të dokumentit përmbarimor – vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-560/192, të datës 24.02.2020, me të cilin Urdhër është detyruar debitorja Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK, me seli në

Prishtinë, që në emër të borxhit për dy paga jubilarë për 20 vite të përvojës së punës, t'ia paguaj shumën prej 834.96 euro.

Kundër këtij Urdhëri Përmbarrimor, brenda afatit të paraparë ligjor prapësim ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuari i debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë. Në prapësim, theksohet e se propozimi për përmbarrim është paraqitur në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 5, neni 36 paragrafi 1, neni 37 dhe nenin 38 i LPP së, pasi që propozimit për përmbarrim nuk i është bashkangjitur dokumenti përmbarrues në origjinal, apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit. Po ashtu, pretendohet se propozimi për përmbarrim është paraqitur në kundërshtim me nenin 144 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili parasheh që akti administrativ ekzekutohet kur hynë në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vetë organi administrativ i cili e ka nxjerrë këtë vendim, ndërsa vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi nuk është bërë ende i ekzekutueshëm, pasi që debitori ende pa e pranuar vendimin e inspektoratit dhe pa kaluar afati i ankimit, përmbarruesi privat ka nxjerr urdhër për përmbarrim, pra vendimi i inspektoratit është nxjerr me datën 24.02.2020, kurse urdhëri për përmbarrim është marrë me datën 28.02.2020, që dmth pa kaluar afati paritiv për përmbarrim e obligimit. Ka theksuar se debitori vendimin e inspektoratit e ka pranuar me datën 02.03.2020 dhe sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka pas të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, të drejtë të cilën debitori e ka shfrytëzuar pranë organit të shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës dhe ende nuk ka pranuar përgjigje lidhur me këtë ankesë. Po ashtu ka shtuar se nuk mund të ekzekutohet akti administrativ kundër të cilit është bërë ankesa dhe ndaj të cilit nuk është paraparë klauzola se ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e aktit administrativ. Tutje ka theksuar se akti administrativ ekzekutohet vetëm atëherë kur kanë përfunduar të gjitha procedura administrative dhe paraprakisht iu është dhënë mundësia personit fizik apo juridik që vullnetarisht ta zbatoj aktin administrativ, ndërsa përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin para se debitori të pranojë këtë vendim nga ana e Inspektoratit të Punës, dhe pa kaluar afati ligjor brenda të cilit debitori ka pasur të drejtën e ankimit. Po ashtu ka theksuar se përmbarruesi privat ka bërë konstatim të gabuar të drejtës materiale dhe gjendjes faktike pasi që bazuar në listën e pagave dhe vërtetimin e lëshuar nga debitori shihet se kreditori ka pagën bazë 314.00€, ndërsa përmbarruesi privat si shumë të njëjta ka paraqitur vlerën 378.48€, që do të thotë se shuma e përgjithshme duhet të jetë 628.00 euro, ndërsa përmbarruesi ka paraqitur vlerën prej 756.96 euro, ku ka futur edhe shtesat në pagë, si shujtën dhe kujdestarit, e që është në kundërshtim me Kontratën Sektoriale, e cila e njeh vetëm pagesën e pagës mujore e jo edhe shtesat. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të hedhet poshtë si i pa bazuar propozimi për përmbarrim.

I autorizuari i kreditorës brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se pretendimet e cekura në prapësim nuk qëndrojnë ngase organi përmbarrues urdhërin për përmbarrim e ka nxjerr në kuptim të nenit 22 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, dhe si i tillë i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas nenit 24 par.3 i LPP-së. Tutje pretendimet se dokumenti përmbarrimor nuk është dorëzuar tek organi përmbarruesi nuk qëndronë ngase i njëjti është dorëzuar në origjinal në kuptim të nenit 38 par.1 të LPP-së. Po ashtu ka theksuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se dokumenti përmbarrimor në bazë të së cilit është nxjerr vendimi nuk e ka vërtetimin e përmbarrueshmërisë në kuptim të nenit 36 të LPP-së, sepse në kuptim të nenit 24 par.5 të LPP-së, është paraparë: "Përmbarrimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin.". Gjithashtu ka parashtuar se dokumenti përmbarrimor në rastin konkret i plotëson të gjitha konditat sepse me ligj të veçantë përkatësisht me nenin 6.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës, është paraparë se

ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të nxjerrë nga Inspektorati i punës, dhe mbi këtë bazë vendimi nuk ka nevojë të ketë klauzolën e plotfuqishmërisë në kuptim të nenit 24 par.5 të LPP-së, por i nënshtrohet ekzekutimit pa u bërë përfundimtar. Tutje ka theksuar se pretendimi se me rastin e marrjes së vendimit inspektorati gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka aplikuar gabimisht drejtën materiale, nuk qëndrojnë ngase organi përmbaues nuk merret me vlerësimin se akti administrativ në procedurë administrative a është nxjerr në përputhje me dispozitat e parapara ligjore, por vetëm me atë se ky akt a është i përmbaueshëm në procedurën përmbaimore dhe a ka skaduar afati vullnetar për përmbaimin. Ka theksuar se ky akt i plotëson të gjitha kushtet nga neni 38 par.1 i LPP-së, për tu lejuar nga organi përmbauesi. Bazuar në këto pretendime, ka vlerësuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në nenin 69 par.5 dhe nenin 71 të LPP-së, andaj ka propozuar që i njëjti të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbaimit.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorës të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkrësive të lëndës gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, përcakton llojet e dokumenteve përmbauese, ku në nënpar 1.2 parasheh që: *“Dokumente përmbauese janë: vendimi përmbaues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*. Tutje, dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbaimit, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbaimit në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbaimit. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbaimit është i përshtatshëm për përmbaimit në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumën dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, në mënyrë që dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbaimit t'i njihet cilësia e dokumentit të përshtatshëm për përmbaimit.

Në rastin konkret, përmbaimit është lejuar në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-560/192, të datës 24.02.2020. Nga vlerësimi i këtij dokumenti, Gjykata gjen se i njëjti paraqet vendim të dhënë në procedurë administrative, si dhe përmban të dhëna për kreditorin, debitorin, objektin, mjetet, shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit dhe si i tillë i përmbushë të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara nga nenet 22, 24 dhe 27 të LPP-së për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbaimit, në kuptim të dispozitës nga neni 21 të LPP-së, e cila parasheh që: *“Organi përmbaues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaimit vetëm në bazë të dokumentit përmbaues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit dhe ka ardhur në përfundim, se në rastin konkret urdhri për lejimin e përmbaimit duhet të shfuqizohet pjesërisht për shumën prej 78.00 euro, shpenzime këto që i referohen përpilimit të ankesës pran Inspektoratit të Punës. Kjo për faktin se në dokumentin përmbaimit gjegjësisht vendimin e inspektoratit të punës shumën në fjalë nuk është njohur nga ky organ si obligim i debitorës kundrejt kreditorës, andaj, në rastin konkret përmbauesi privat nuk ishte dashur që të bëjë tejkalim të të detyrimeve të përcaktuara në dokument përmbaimit.

Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se debitori me dokumentin përmbarimor është detyruar që ta përmbush borxhin në emër të pagave jubilarë vetëm në shumën prej 756.96 Euro, gjykata konstaton se debitori ndaj kreditores i ka borxh vetëm këtë shumë e cila është cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, kurse për pjesën tjetër gjykata pjesërisht e pranoj prapësimin e debitorit për shumën prej 78.00€, duke e shfuqizuar urdhrin sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata me rastin e vendosjes trajtoi pretendimet e ngritura nga ana e debitorit lidhur me faktin se në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, akti administrativ ekzekutohet kur hyn në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vetë organi administrativ i cili e ka nxjerrë aktin, ndërsa në rastin konkret vendimi në fjalë nuk është bërë i ekzekutueshëm sepse sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, të cilën të drejtë debitori e ka shfrytëzuar.

Lidhur me këto pretendime, Gjykata iu referua Ligjit për Inspektoratin e Punës, përkatësisht dispozitës së nenit 6 par.4 të të njëjtit, ku përcaktohet: “Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”. Në kontekst të njëjtë, dispozita nga neni 24 par.5 e LPP-së parasheh që: “Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin”. Në bazë të interpretimit të këtyre dispozitave, Gjykata vlerëson se fakti që palët kanë pasur të drejtën e ankesës ndaj vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, nuk paraqet kurrfarë pengese për caktimin e përmbarimit duke iu referuar vendimit në fjalë, pasi dispozitat e lartëcekura janë të karakterit përjashtues dhe si të tilla ua japin cilësinë e dokumentit përmbarues edhe vendimeve të cilat nuk e kanë formën e prerë apo që nuk janë bërë përfundimtare, siç ka ndodhur në rastin konkret.

Bazuar në një vlerësim të tillë, Gjykata pretendimet e parashtrura nga ana e debitorit i ka vlerësuar pjesërisht si të bazuara, andaj, mbi këtë bazë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit për shumën prej 78.00 Euro, dhe duke e lënë në fuqi Urdhërin Përmbarimor për shumën 756.96 Euro.

Mbi bazën e arsyeve të lartëcekura, në kuptim të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
PPP.nr.438/2020, datë 06.11.2023

G j y q t a r i,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.